## Politika e Privatësisë Administrimi i anëtarëve

Mbrojtja e të dhënave tuaja personale është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme për ne. Në këtë informacion për mbrojtjen e të dhënave do t'ju informojmë për aspektet më të rëndësishme të përpunimit të të dhënave në kuadrin e administrimit të anëtarëve. Një informacion të plotë se si ÖGB i trajton të dhënat tuaja personale mund ta gjeni te **www.oegb.at/datenschutz.**

ÖGB është përgjegjëse për përpunimin e të dhënave tuaja. Ne i përpunojmë të dhënat e ofruara nga ju mbrapa faqes me një shkallë të lartë konfidencialiteti, vetëm për qëllime të administrimit të anëtarëve të sindikatës dhe për sa kohë zgjat anëtarësimi juaj ose për sa kohë që mund të keni ende pretendime nga anëtarësimi. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave është anëtarësimi juaj në ÖGB; në rast se keni rënë dakord që pagesa e anëtarësisë të zbritet automatikisht nga rroga, bazë është pëlqimi juaj për përpunimin e të dhënave shtesë të kërkuara për këtë.

Përpunimi i të dhënave kryhet nga vetë ÖGB ose nga përpunues të tjerë të dhënash, të porositur nëpërmjet një kontrate dhe të kontrolluar nga ÖGB-ja. Çdo transferim tjetër i të dhënave te palë të treta nuk bëhet ose bëhet vetëm me pëlqimin tuaj të shprehur qartë. Përpunimi i të dhënave bëhet vetëm brendapërbrenda BE-së.

Lidhur me përpunimin e të dhënave tuaja personale ju keni kundrejt ÖGB-së të drejtën e informacionit, korrigjimit, fshirjes dhe kufizimit të përpunimit. Ju mund të paraqitni në çdo kohë një ankesë pranë Autoritetit Austriak për Mbrojtjen e të Dhënave (www.dsb.gv.at) si organ mbikëqyrës kundër çdo përpunimi të të dhënave tuaja, që ju e konsideroni të papranueshëm.

**Mund të na kontaktoni në këtë mënyrë:**
Österreichischer Gewerkschaftsbund (Federata e Sindikatave Austriake)
Johann_Böhm-Platz 1, A-1020 Wien
Telefon: +43 / 1 / 534 44-0; E-Mail: oegb@oegb.at

Të ngarkuarin tonë me mbrojtjen e të dhënave mund ta kontaktoni këtu: **datenschutzbeauftragter@oegb.at**

ANTWORTSENDUNG

vida

**Gewerkschaft vida**
Johann-Böhm-Platz 1
1020 Wien

*Porto zahlt EmpfängerIn!*




## Çfarë përfitime kanë anëtarët

- Këshillime për të gjitha çështjet e së drejtës së punës dhe sociale, Tel: +43 1 53444 79148
- Mbrojtje ligjore falas para Gjykatës së Punës për anëtarët tanë në rast konfliktesh
- Përfaqësim falas para gjykatave, sigurimeve shoqërore dhe institucioneve të pajtimit
- Sigurim i mbrojtjes ligjore në rast të dëmshpërblimeve dhe të problemeve që dalin gjatë punës
- Ndihmë kundër bullizmit dhe dhunës në punë, Tel.: +43 1 53444 39100
- Sigurim i aksidenteve që ndodhin në kohën e lirë, i pagesës në spitalet e aksidenteve dhe i shpenzimeve të funeralit: arbeitnehmerinnenschutz@vida.at
- Mbështetje e veçantë për anëtarët që ndodhen në një situatë tepër të vështirë dhe ata në nevojë (informacione më të hollësishme mund të merrni nga Sekretariati i vida-s në landin tuaj)
- Mbështetje gjatë periudhës së papunësisë (informacione më të hollësishme mund të merrni nga Sekretariati i vida-s në landin tuaj)
- Ndihma për personat me aftësi të kufizuara, Tel: +43 1 53444 79595
- Mbështetje për arsim dhe trajnim, Tel.: +43 1 53444 79690
- Oferta të lira për pushime dhe bileta me ulje çmimesh për ngjarje kulturore dhe sportive
- Vida-Card – ulje çmimi nga shumë firma
- Revista „vida" dhe ÖGB „Solidarity" dërgohen në shtëpi pa pagesë

Më shumë informacione mund të gjeni te: **vida.at/vorteile**

**Impressum:**
Botues: ÖGB/ Sindikata vida, ÖGB-ZVR-Nr: 576439352, DVR-Nr.: 0046655, Pronari i medias dhe prodhuesi: Shtëpia Botuese e ÖGB-së GesmbH, vendi i Shtëpisë Botuese dhe i prodhimit: 1020 Wien, Johann-Böhm-Platz 1, Figurat © Shtëpia Botuese e ÖGB-së/Michael Mazohl & Paul Sturm




## Sindikata vida për të gjithë Austrinë

**Selia e vidas (Catamaran)**
Johann-Böhm-Platz 1
1020 Wien
Tel.: +43 1 53444 79
info@vida.at

### Sekretariatet në lande

**Burgenland**
Wiener Straße 7
7000 Eisenstadt
Tel: +43 2682 770 71000
burgenland@vida.at

**Karintia**
Bahnhofstraße 44
9020 Klagenfurt

Bahnhofplatz 1
9500 Villach

Tel: +43 463 5870 72000
kaernten@vida.at

**Austria e Poshtme**
Gewerkschaftsplatz 1
3100 St. Pölten

Schwechat, Office Park 3
1. Obergeschoß, Top 122
1300 Wien, Flughafen

Tel: +43 2742 311941 730
niederoesterreich@vida.at

**Austria e Epërme**
Volksgartenstraße 34
4020 Linz
Tel: +43 732 653397 740
oberoesterreich@vida.at

**Salcburg**
Markus-Sittikus-Straße 10
5020 Salzburg
Tel: +43 662 871228 750
salzburg@vida.at

**Shtajermark**
Karl-Morre-Straße 32
8020 Graz
Tel: +43 316 7071 76000
steiermark@vida.at

**Tirol**
Südtiroler Platz 14–16
6020 Innsbruck
Tel: +43 512 59777 77000
tirol@vida.at

**Vorarlberg**
Widnau 2
6800 Feldkirch
Tel.: +43 5522 3553 78000
vorarlberg@vida.at

**Vjenë**
Triester Straße 40/3/1
1100 Wien
Tel: +43 1 53444 79680
wien@vida.at

vida

Albanisch

# SINDIKATA NE JETOJMË




vida

vida.at

## Çfarë është vida?

**vida** është sindikata austriake e transportit dhe shërbimeve. Njerëz nga profesione të ndryshme janë anëtarë të vida-s.



## vida në spanjisht do të thotë „jetë“

**Që të jetosh më mirë** duhet të veprosh. Grupe të caktuara profesionale si punëtorët e hekurudhave, punonjësit në shërbimet e sigurisë, në tregti dhe shërbimet sociale, personeli sanitar dhe ai spitalor, mirëmbajtësit e banesave, ekipet e pastrimit, punonjësit në turizëm dhe gastronomi, parukierët dhe estetistët, si dhe punonjësit në sektorin e lundrimit, shoferët profesionistë, pilotët dhe stjuardesat punojnë ditë e natë për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e jetës sonë.

Kjo kërkon shumë forcë dhe shumë punë. Por kush angazhohet për përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre punëtorëve? Këtë e bëjmë ne, si Sindikata vida.

Së bashku me përfaqësuesit e punonjësve në vendin e punës, ne luftojmë për të drejtat tuaja si punonjës. Ne nuk i frikësohemi konfliktit, as gjatë tratativave për kontratat kolektive apo pagat, as kur bëhet fjalë për të drejtat e punonjësve.

## Të jetosh në solidaritet me të tjerët

Kur të gjithë luftojnë kundër të gjithëve në botën e punës dhe në shoqëri, askush nuk fiton gjë. Anëtarësimi në vida ka vlerë. Çdo anëtar mbrohet nga bashkësia dhe në të njëjtën kohë e bën atë më të fortë. Ne jemi një sindikatë që mund ta prekni dhe ta transformoni, sepse ne jetojmë në sindikatë.



## vida është zëri juaj

- vida lufton për kushte të mira pune dhe angazhohet që të keni një kohë të lirë të rregullt.
- vida punon fort për përmirësimin dhe ruajtjen e vendeve të punës.
- vida negocion çdo vit më shumë se 100 marrëveshje kolektive me punëdhënësit, në të cilat përcaktohen paga më të drejta, shpërblimet për Krishtlindje dhe pushimet, si dhe shumë kushte të tjera të përgjithshme.
- vida mbështet dhe këshillon përfaqësuesit e punonjësve dhe të të rinjve gjatë punës së tyre me këshilla ligjore, materiale informative ose në negocimin e marrëveshjeve brenda ndërmarrjeve.
- vida zhvillon lobim politik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Ne duam që politika të krijojë kushte të përgjithshme, të cilat bëjnë të mundur paqen, sigurinë dhe mirëqenien për njerëzit.

## Informacion sipas nevojës

- **vida online**
  Lajme, tema dhe oferta online në vida.at. vida është në dispozicionin tuaj në internet 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, 365 ditë në vit.





gemeinsam_vida

gewerkschaftvida

- **vida në rrjet**
  Na ndiqni në Twitter e Facebook dhe mos humbisni më asnjë të re nga Sindikata vida! Mirëpresim komentet, pëlqimet dhe mesazhet tuaja personale. Bashkëpunoni dhe tregojuni kolegeve e kolegëve, si dhe miqve tuaj për këtë.
- **Dëgjoni vidën**
  vida mund edhe të dëgjohet. Shkarkoni podcast-in tonë vidaHören:
  **vida.at/podcast**




- **vida informon**
  Qëndroni të përditësuar me revistën vida dhe buletinin vida: thjesht regjistrohuni për buletinin te:
  **vida.at/newsletter**
  Të gjitha numrat e revistës vida mund të gjehen për t'u lexuar te:
  **vida.at/magazin**

## Kuota e anëtarësimit

Pagesa mujore e anëtarësimit është një përqind e të ardhurave bruto. E përllogaritur sipas orarit tuaj të punës do të thotë se janë vetëm 4 minuta e 48 sekonda në ditë për një javë 40-orëshe, që ju i shpenzoni për detyrimet ndaj sindikatës.

Për pensionistët, të papunët dhe ata që janë përkohësisht sëmurë kuota e anëtarësimit është më e ulët. Informacione të mëtejshme për shërbimet tona dhe shumat e sakta mund të merrni në sekretariatet tona të landeve, shikoni mundësitë për t'i kontaktuar ato në anën e pasme të faqes.

Meqë ra fjala: Shuma e plotë e kuotës së anëtarësimit mund të zbritet nga tatimi mbi të ardhurat duke i reduktuar në këtë mënyrë taksat. Nëse kuota e anëtarësimit zbritet drejtpërdrejt nga paga (Betriebsabzug), ulja e taksës duket menjëherë edhe në llogarinë e pagës.

## vida Regjistrim për anëtarësi

*Dorëzohet ose dërgohet te: shih prapa faqes*

Emri | Mbiemri

Titulli | Grada akademike ((e prapavendosur)) | Shtetësia

Numri i Sigurimeve Shoqërore (për zbritje direkt nga rroga) | Datëlindja | ☐ Mashkull ☐ Femër

Rruga | Numri i shtëpisë

Kodi postar | Vendi

Telefoni | E-Mail

Profesioni aktual/Detyra gjatë shërbimit/mësimdhënës | ☐ Me orar të plotë ☐ Me orar të reduktuar | ☐ I punësuar minimalisht

Nxënës në një profesion:
Fillimi i praktikës | Fundi i praktikës

I punësuar në firmën/institucionin Rruga, numri i shtëpisë (së firmës/institucionit)

Rroga/Paga mujore bruto në € ______
(Kuota e anëtarësimit në sindikatë përbën 1 përqind të kësaj. Informohuni te: www.vida.at/mitgliedsbeitrag)
| Data e anëtarësimit

ZVR-Nr. 576439352

**Unë e paguaj kuotën time të anëtarësimit me anë të** (shënoni me kryq çfarë vlen për ju):

☐ **Zbritjes nga paga/rroga (zbritje nga ndërmarrja):**
Deklaroj se jam dakord me zbritjen nga ndërmarrja, d.m.th. kontributi im për sindikatën mund të zbritet nga punëdhënësi/shërbimdhënësi im prej pagës a rrogës sime, ose dëmshpërblimit tim si nxënës në një profesion; ose të më mbahet nga pensioni dhe të transferohet nga zyra që ma paguan pensionin; dhe prandaj jap pëlqimin tim që të dhënat e mia personale, të cilat kërkohen për mbledhjen e kontributeve, konkretisht të dhënat e përmendura më sipër dhe anëtarësimi në sindikatë, numri i sigurimeve shoqërore, numri i personelit, të dhënat e kontributeve, lloji i kontratës kolektive, datat e hyrje-daljeve, periudhat e ndërprerjes së punës, data e daljes në pension, koha e shërbimit ushtarak dhe atij civil, si dhe të dhënat në lidhje me ndryshimin e adresës mund të përpunohen nga punëdhënësi im dhe sindikata, ndërkohë që unë mund ta tërheq këtë pëlqim ndaj ÖGB-së për zbritje nga ndërmarrja në çdo kohë..

☐ **Mandati i debitimit direkt SEPA:** Referenca e mandatit: G07005785824
Unë autorizoj Federatën e Sindikatave Austriake (ÖGB) ose sindikatat e bashkuara në ÖGB të tërheqin pagesa të përsëritura nga llogaria ime nëpërmjet mandatit me debitim të drejtpërdrejtë SEPA. Në të njëjtën kohë, unë udhëzoj bankën time të shlyejë debitimet direkte SEPA të tërhequra prej llogarisë sime nga ÖGB. Unë mund të kërkoj rikthimin e shumës së tërhequr brenda tetë javësh, duke filluar nga data e debitimit. Në këtë rast vlejnë kushtet për të cilat kam rënë dakord me bankën time.

Nëse kam rënë dakord për zbritje direkt nga rroga, por nuk e dua më këtë gjë ose do të largohem nga ndërmarrja ose nuk është më e mundur të zbritet kuota e anëtarësimit nëpërmjet kompanisë, kërkoj që ta ndryshoj mënyrën e pagesës me debitim direkt SEPA nga llogaria që kam dhënë pa ndonjë miratim paraprak.

Përfituesi i pagesës: Federata Austriake e Sindikatave, Johann-Böhm-Platz 1, 1020 Vjenë, ID e kreditorit: AT48ZZZ00000006541

Banka ______ Pronari i llogarisë ______

IBAN ______ BIC ______

Vendi ______ Data ______ Nënshkrimi ______

Unë konfirmoj se e kam parasysh **informacionin mbi mbrojtjen e të dhënave të sindikatave në anën e pasme të faqes** (që gjendet gjithashtu në www.oegb.at/datenschutz). Pasi merrni kartën e anëtarësimit, mund të përdorni numrin tuaj të anëtarësimit për të marrë të gjitha informacionet e rëndësishme si kontrata kolektive, informacione mbi temat aktuale, aktivitetet, etj. Kuota e anëtarësimit mund të zbritet nga taksat. Më shumë informacion në: **www.vida.at**

☐ Jam dakord që ÖGB, Shtëpia Botuese e ÖGB-së dhe/ose VÖGB mund të më kontaktojnë me telefon ose e-mail (§107 TKG) për të më ofruar informacione rreth shërbimeve të ndryshme, të tilla si oferta për bileta, libra, shfaqje etj., si dhe për të më transmetuar informacione të tjera. Këtë pëlqim mund ta tërheq në çdo kohë.

| Vendi | Data | Nënshkrimi |
|---|---|---|

Referuar nga:

| Emri | Mbiemri | Numri i anëtarësimit | Arsyeja e anëtarësimit |
|---|---|---|---|

Quelle: vida Imagefolder 2020